



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2018, ora 09.30

Drejton mbledhjen

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit
2. Diskutimi në parim i deficitit buxhetor dhe borxhit publik të projektbuxhetit të vitit 2019.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Reme Lala, Ervin Bushati dhe Roland Xhelilaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj - Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Gelardina Prodani - Sekretare e përgjithshme e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Endrit Lami - Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Marjush Borokoci - përgjegjës sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Arbër Lleshi - këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Knidi Bashari - këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Sot në rendin e ditës ka vetëm një çështje: jemi në kuadrin e diskutimit të buxhetit të shtetit për vitin 2019. Sot do të diskutojmë lidhur me deficitin buxhetor dhe borxhin publik të parashikuar për vitin 2019.

Për të prezantuar këto çështje ndodhet në Komisionin e Ekonomisë, ministri i Financave dhe Ekonomisë, zoti Arben Ahmetaj. Relator i komisionit lidhur me këtë çështje do të jetë zonja Evis Kushi.

Do të vijojmë me prezantimin dhe pastaj me relatimin në emër të komisionit, pyetje dhe diskutime.

Fjalën e ka ministri.

Arben Ahmetaj – Borxhi publik është elementi kryesor i financave publike rreth të cilit, siç e kemi thënë disa herë, ankorohet i gjithë procesi i programimit të buxhetit vjetor dhe atij afatmesëm.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë është e fokusuar në uljen e vazhdueshme të borxhit publik si një element i domosdoshëm për konsolidimin e financave publike.

Të gjithë biem dakord që niveli aktual i borxhit publik për vendin tonë është i lartë dhe mbart risqe për stabilitetin makro-ekonomik të vendit, pra është imperative reduktimi i borxhit në nivele që konsiderohen të sigurta për ekonominë tonë.

Në vitin 2016, këtë synim strategjik të politikës fiskale, pra domosdoshmërinë për konsolidim fiskal dhe uljen e raportit të borxhit publik, e fiksuam edhe në ligjin kryesor “Për menaxhimin e financave publike”, pra në ligjin organik të buxhetit. Tashmë është e sanksionuar edhe me ligj, që çdo qeveri jo vetëm që nuk mund ta rrisë borxhin publik, por është e detyruar që në çdo raund të programeve të buxheteve vjetore, apo atyre afatmesëm, të targetojë për çdo vit një nivel më të ulët të raportit të borxhit publik ndaj prodhimit të brendshëm bruto sesa viti pararendës dhe kjo duhet të vijojë deri kur ne si vend të kemi arritur objektivin strategjik të një niveli borxhi prej 45% të prodhimit të brendshëm bruto, nivel i cili vlerësohet gjerësisht si niveli më optimal për një ekonomi si jona. Me nivel optimal të borxhit publik kam parasysh atë nivel

që, nga njëra anë, lë hapësirën e arsyeshme për të përdorur konceptin e borxhit si një instrument efikas për të përshpejtuar zhvillimin e vendit dhe ekonomisë me një ritëm më të shpejtë sesa ai do të zhvillojë nëse nuk do të *utilizonim* borxhin si instrument zhvillimi, por, nga ana tjetër, siguron qëndrueshmërinë afatgjatë të financave publike dhe rrjedhimisht stabilitetin makro-ekonomik, shtyllë kjo pa të cilën asnjë ekonomi nuk do të bënte dot përpara në afatgjatë. Thënë kjo, ulja e borxhit publik është detyrë patriotike e çdonjërit prej nesh.

Në këtë frymë, politika fiskale që materializohet në buxhetin e vitit 2019 vijon të ketë si ankorë kryesore të saj konsolidimin fiskal dhe uljen e mëtejshme të borxhit. Në këtë aspekt, më lejoni të përmend disa nga targetet kryesore të politikës fiskale të materializuar në buxhetin e vitit 2019:

- Në vitin 2019 targetojmë një reduktim të borxhit publik me rreth 2 pikë për qind. Këtu i referohemi konceptit të borxhit neto, i zhveshur nga efekti momental i *Eurobond*-it, që do ta shpjegojmë me detaje më pas.

- Në afatin e mesëm, synojmë të ulim borxhin rreth 60 % në vitin 2021 në përputhje me premtimin tonë elektorale.

- Niveli i deficitit të përgjithshëm që ne targetojmë në buxhetin e vitit 2019 është 1,9 % i prodhimit të brendshëm bruto. Pra, vijon të jetë me ulje nga targeti i një viti më parë dhe vijon të jetë niveli më i ulët që është targetuar historikisht në një ligj buxheti.

- Niveli i balancës primare, edhe këtë vit ashtu si tre vjetët e shkuar, targetohet në nivel pozitiv, pra me suficit prej 0,5 % të prodhimit të brendshëm bruto nga 0,3% suficit që pritet të realizohet gjatë këtij viti.

- Një tjetër parametër shumë i rëndësishëm i buxhetit është balanca koherente e tij, e cila tregon në terma makro se në ç'mënyrë eficiente përdoret borxhi që merret nga qeveria gjatë një viti të caktuar. Për këtë do të ndalem më pas me disa tregues analitik dhe krahasimorë.

- Tashmë e kemi deklaruar qartë se një nga prioritetet kryesore të kësaj qeverie, të mishëruar në buxhetin e vitit që vjen, por natyrisht edhe përgjatë gjithë këtij mandati, janë investimet publike. Gjykoj se një ndër elementet më optimale për ekonominë e vendit është që, ndërkohë që targetojmë një reduktim të nivelit të borxhit me 2 pikë për qindje vetëm në harkun kohor të një viti, në të njëjtën kohë arrijmë të programojmë investime publike në nivelin prej 5 % të prodhimit të brendshëm bruto. Pra, rrjedhimisht ky buxhet targeton një balancë koherente pozitive nga më të lartat historike prej 3,2% plus të prodhimit të brendshëm bruto. Kjo sigurisht

që respekton katërçipërisht edhe rregullin tjetër fiskal të sanksionuar në ligjin organik të buxhetit, të raportit të investimeve publike me huamarrjen vjetore, ashtu siç njihet ndryshe, si rregulli i artë fiskal.

Kjo ishte një mënyrë e përmbledhur e prezantimit sa u takon objektivave dhe targeteve kryesore të politikës fiskale për vitin që vjen dhe afatmesëm.

Ndërkohë, dua të ndalem dhe të ndaj me ju shkurtimisht qasjen që do të kemi sa i takon menaxhimit të borxhit publik në periudhën afatmesme në vijim:

Gjatë vitit 2019 dhe në vijim, përveç reduktimit të konsiderueshëm të ekspozimit ndaj risqeve, rëndësi e veçantë do t'i kushtohet aktiviteteve, të cilat do të kenë në fokus zhvillimin e mëtejshëm të tregut të titujve shtetërorë. Në periudhën afatmesme, mesatarisht rreth 85 % e nevojave të përgjithshme për financim do të realizohen nëpërmjet burimeve të brendshme. Niveli i financimit të brendshëm në terma neto do të synohet të mbahet i qëndrueshëm duke mos tejkaluar kapacitetet optimale të tregut, që janë rreth 20- 22 miliardë, mendohet në 19 miliardë.

Duke qenë se normat e interesit priren të qëndrojnë ende të ulëta për një kohë të shkurtër në të ardhmen, financimi i brendshëm do të orientohet kryesisht në drejtim të titujve afatgjatë me norma interesi fikse, me qëllim reduktimin e risqeve me kosto sa më të ulët.

Titujt afatshkurtër, kryesisht do të shërbejnë për të rifinancuar maturimin e titujve ekzistues, si edhe menaxhimin aktiv të nevojave për likuiditete.

Financimi i huaj do të shërbejë si një plotësues i mirë i burimeve të brendshme dhe, përveç të tjerave, edhe si optimizues i kostove të borxhit. Ky financim do të mbështetet në huatë me terma pjesërisht të buta, të cilat do të financojnë projektet ekzistuese dhe projektet e reja të konsideruara si prioritare nga qeveria për zhvillimin e vendit.

Së dyti, në huatë me terma të buta të akorduara nga institucionet ndërkombëtare financiare për të mbështetur politikën në instrumentet financiare të tregjeve të kapitalit mbi baza oportune dhe kryesisht për të mundësuar një menaxhim aktiv të detyrimeve të borxhit dhe për të optimizuar risqet e portofolit.

Zhvillimi i mëtejshëm i tregut primar vendas dhe hedhja e hapave për zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë, është një tjetër objektiv afatmesëm, realizimi i të cilit do të shoqërohet me aktivitete, të cilat do të kenë në fokus krijimin dhe standardizimin e madhësive *banch-mark* për titujt afatgjatë nëpërmjet konsolidimit të numrit të ankandeve dhe rritjen e frekuencës së rihapjeve, reduktimin e fragmentimit të kërkesës nëpërmjet konsolidimit të numrit

të titujve shtetërorë të tregtueshëm, rritjen e transparencës nëpërmjet konsultimit të vazhdueshëm me aktorët kryesorë të tregut dhe raportimin e publikimit periodik të të dhënave të borxhit, përdorimit të ankandëve të riblerjes *bybackactions* dhe shkëmbimit për të rritur eficiencën në procesin e reduktimit të ekspozimit ndaj risqeve, përmirësimin dhe standardizimin e rregullave të emetimit të titujve shtetërorë, analizimi i rezultateve të projektit pilot për emetimin e obligacioneve 5-vjeçare referencë dhe shqyrtimi i mundësisë së bashkëpunimit me aktorët kryesorë të tregut për shtrirjen e këtij projekti dhe tek titujt e tjerë afatgjatë, përmirësimi i kuadrit ligjor rregullator dhe diversifikimi dhe zgjerimi i bazës së investitorëve.

Në *slide presentation*, do të kemi mundësinë t'i shohim, unë kam bërë një krahasim midis periudhave të dy mandateve të Partisë Demokratike dhe mandatit të parë të Partisë Socialiste: nëse marrim si tregues krahasues lekë të investuara për çdo lek të marrë borxh, ku lekët e marra borxh janë shtesa e stokut të borxhit, na rezulton se mesatarisht në çdo vit të periudhës 2006-2013, pra në dy mandatet e Partisë Demokratike, për çdo 100 lekë, që është shtuar stoku i borxhit, janë investuar 118 lekë, ndërsa mesatarisht në çdo vit të periudhës 2014-2017, pra, mandati i parë i Partisë Socialiste, për çdo 100 lekë, që është shtuar stoku i borxhit, janë investuar 195 lekë, (ju të medias, këtë duhet të mbani shënim!). Në dy mandate të Partisë Demokratike, në 100 lekë të marra borxh janë investuar 118 lekë. Në një mandat të Partisë Socialiste, në 100 lekë të marra borxh, janë investuar 195 lekë, pra lidhja me rregullin e artë, gjithashtu. Ndërkohë, për buxhetin e vitit 2019, ky raport është programuar të jetë për çdo 100 lekë të marra borxh, do të investohen 253 lekë (ju të medias, që i mbani shënim). Kjo do të thotë se, krahasuar me periudhën 2006-2013, në dy mandatet e PD-së, ky raport përmirësohet, krahasuar me atë mandat kur ka qenë 114 %, ose rreth 2,1 herë më i lartë. Ndërsa, krahasuar me periudhën tonë, 2014-2017, përmirësohet me 30 %.

Në vazhdimësi, sigurisht që do t'i detajojmë edhe elementet e maturimit të borxhit apo detajet e tjera, por ajo që dua të ndaj me komisionin, por edhe me ata që na ndjekin nëpërmjet medias është: praktikisht dalja e Shqipërisë në treg, në tetor të këtij viti, ishte test i patjetërsueshëm i ekonomisë dhe financave publike. Pse e them këtë? Pavarësisht debateve politike majtas dhe djathtas, që natyrshëm kemi këtu, pavarësisht qëndrimeve që mban maxhoranca apo opozita në raport me financat publike, pavarësisht se në Gjermani, Kancelarja Merkel, Presidenti Macron në Francë e mbështesin Shqipërinë pafundësisht, pavarësisht se klima pro Shqipërisë është shumë pozitive, tregjet janë të ftohtë. Tregjet nuk gjykojnë kush është

në krye të qeverisë dhe kush e mbështet këtë qeveri ose sa e do iksi kryeministrin ose sa e mbështet ypsiloni kryeministrin. Tregjet janë të ftohtë, të gjykojnë me ftohtësi dhe e kanë raportin në gjykim në favor të sigurisë të biznesit që ata bëjnë me Shqipërinë. Praktikisht ne arritëm të dilnim me një kupon **prajs** 3,5 % që është gati dy herë më i vogël se në vitin 2015 dhe 3 herë më i vogël se në vitin 2010. Brenda një mandati perceptimi i risqeve për ekonominë dhe financat e Shqipërisë është ulur gati 2 herë. Këtë e gjykojnë investitorë, të cilët kanë zë dhe peshë në tregun financiar e tregtar të letrave sovraane, si Gorman Saks, Xhepi Morgan, Pinko, Fond Aberdin.

Gjithashtu, dua sërish të ndaj me komisionin dhe me ata që na ndjekin nëpërmjet medias se perceptimi i riskut për financat e Shqipërisë ka reflektuar pozitivisht edhe në nivelet e fondeve të pensioneve. Siç e kam thënë, janë dy vende nordike që kanë fonde pensionesh shtetërore që kanë investuar tek eurobondi i Shqipërisë njëri është fondi i pensioneve të kompanisë së hekurudhave franceze që ka investuar tek eurobondi i Shqipërisë. Pra, siguria ndaj shëndetshmërisë së financave të ekonomisë dhe investitorëve është rritur dyfish, perceptimi i risqeve është ulur dyfish dhe kjo ka ardhur për ato arsye që unë u mundova t'i rendis në përgjithësi më lart.

Një nga referencat më të rëndësishme është edhe maturimi i borxhit të brendshëm, i cili në vitin 2013 ka qenë rreth 540 ditë, sot është 805 ditë. Kombinimi i borxhit të brendshëm me të jashtëm, maturimi, është 4,8 vjet. Ka vend për t'u përmirësuar. Illdi mesatar ka zbritur në rekord.

Këtu nuk do të lë pa përmendur risqet e të ardhmes sa i përket interesave që edhe në Europë, por edhe në SHBA-të ka tendencën për rritje, por edhe informacionet e fundit statistikore që kanë institucionet përkatëse sa i përket ngadalësimit të ekonomisë së eurozonës dhe sa i përket riskut që ndodh në ekonominë italiane.

Erion Braçe- Faleminderit!

Po, zonja Kushi.

Evis Kushi – Objektivi kryesor i projektbuxhetit është thellimi i konsolidimit fiskal, i cili reflektohet më së miri në uljen e deficitit buxhetor dhe në uljen e borxhit publik për projektbuxhetin e vitit 2019. Deficiti buxhetor nga 2%, që pritet të realizohet në vitin 2018, parashikohet të ulet në 1,9% e produktit të brendshëm bruto në vitin 2019. Sa i takon bilancit primar pozitiv për të katërtin vit radhazi kemi bilanc pozitiv dhe konkretisht për vitin 2019 parashikojmë suficit në nivelin 0,5% të PBB-së, madje pritet edhe rritje në periudhën afatmesme.

Edhe sa i takon borxhit publik kemi ulje të tij në raport me vitet e mëparshme. Borxhi publik parashikohet të reduktohet nga 69,1% në vitin 2018 në 65,5% e PBB-së në vitin 2019. Në vitet e ardhshme, në fund të mandatit parashikohet për të arritur në nivelin 60%.

Unë nuk po ndalem në detaje të tjera, sepse edhe ministri i prezantoi shumë qartë, por dua të ngre disa çështje për diskutim, të cilat kanë nevojë për një sqarim nga ana e ministrit:

Së pari, po t'i referohemi strategjisë për menaxhimin e financave publike të viteve 2014-2020, objektivi që ne parashikojmë për vitin 2019 për borxhin publik ishte parashikuar të realizohej në vitin 2017 dhe do të zbrisnim në nivelin nën 60% shumë më herët se viti 2021, pra në vitin 2018 ose 2019. Unë doja të dija nga ju se cilët janë faktorët që kanë çuar në shtyrjen e këtij objektivi: A janë marrë masat që edhe ky objektivi të realizohet që të mos ketë shtyrje tjetër?

Së dyti, në projekt, në tabelat fiskale që e shoqërojnë dhe në relacion nuk ka një informacion të qartë sa është vlera e detyrimeve të prapambetura. Kjo është një çështje që u ngrit edhe gjatë seancës së parë kur kishim diskutimin në parim, por unë desha të kem informacion për vlerën e saktë. A është përfshirë kjo vlerë në stokun e borxhit publik?

Së treti, tavani për të gjitha projektet koncesionare ose partneritet publik privat, edhe ato ekzistueset, por edhe ato që janë firmosur rishtaz në vitin 2018 është 46%. Unë desha të di nëse kjo vlerë totale është përfshirë në stokun e borxhit publik? Nëse do të përfshihej sa do të ishte niveli i borxhit dhe i deficitit buxhetor?

Së katërti, në lidhje me stokun e rimbursimit të TVSH-së, a është e përfshirë kjo në nivelin e deficitit buxhetor dhe të borxhit publik?

Së fundi, a ka Ministria e Financave një informacion lidhur me masat që janë marrë për përmirësimin e performancës së ndërmarrjeve apo shoqërive të ujësjellësve apo të sektorit energjetik për të parë nëse i paguajnë ose jo detyrimet? A kanë marrë masa për realizimin e pagesës së detyrimeve të huas në mënyrë që të mos rëndojnë dhe mos të vënë në përgjegjësi buxhetin e shtetit si garantues i huas?

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Kushi për pyetjet!

Më dhatë mundësi për të treguar punën e madhe që ka bërë qeveria për 5 vjet sa i përket uljes së borxhit publik dhe mirëmenaxhimit të financave publike, duke filluar me një vit shumë të vështirë vitin 2013 dhe duke vazhduar edhe me vite më të vështira si 2014 dhe 2015. Ndërkohë vendoi është gjendur përballë domosdoshmërisë për të ulur borxhin publik dhe për të investuar.

Negociatat me Fondin Monetar Ndërkombëtar sa i përket objektivit të borxhit publik ka qenë e vështirë. Aprovimi, nga Fondi Monetar Ndërkombëtar ka qenë e domosdoshme, sidomos 2-3 vitet e para, edhe për shkak të pozicioneve të vështira të bilancit të pagesave, sepse nuk ka qenë kjo situatë, por ka qenë pozicion shumë i vështirë fiskal. Prezenca e Fondit na ka ndihmuar në vitin 2015, i shumëmirëmenaxhuar nga ministri Cani, kur praktikisht dalja në tregun ndërkombëtar me 5,75% u bë e mundur nga prezenca e Fondit Monetar Ndërkombëtar, sepse ka qenë një vit shumë i vështirë. Në fakt, ju që përfaqësoni edhe qytetarët keni pasur gjithë presionin mbi qeverinë që të investonte për të ulur taksa aty ku duhej, për të zëruar, për të përjashtuar në referencë të lehtësive fiskale për qytetarët dhe sipërmarrjen. Nga ana tjetër, keni pasur natyrshëm presionin që duhet investuar, sepse në atë nivel të zhvillimit ekonomik jemi. Kështu që unë u detyrova në emër të qeverisë të negocioja me Fondin Monetar një trajektore më të shëndetshme për ekonominë shqiptare. Trajektorja që ju iu referuat është trajektore e një konsolidimi shumë të egër fiskal, që mund të sillte efekt të kundërt me zhvillimin ekonomik dhe t'i privonte ekonomisë shqiptare investime shumë të rëndësishme. Kështu që ajo trajektore që ju i referoheni ka qenë trajektorja e parë e konsolidimit. Gjatë negociatës brenda marrëveshjes Ministria e Financave arriti të negocionte një trajektore të bashkëaprovuar, të shëndetshme për ekonominë, sipas së cilës do të ulnim borxhin, por do të investonim 5% të PBB-së. Është viti i katërt që e kemi suficit.

Sa i përket pyetjes suaj të dytë për partneritetin publik privat, kontabilizimi i tyre është bazë e standardeve ndërkombëtare. ESA95, madje edhe ESA2010 nuk i kontabilizon ashtu siç i imagjinojnë kushdo qoftë jashtë kësaj sale. Ato janë detyrime vjetore që u referohen pagesave vjetore dhe janë të kontabilizuara si të tilla. Kjo është arsyeja pse ne kemi vendosur që pagesat e partneritetit publik privat të mos kalojnë 5% të totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës, pra për të vendosur një raport rrisht të menaxhueshëm. Jemi shumë poshtë 5-ës dhe në afat mesëm asnjëherë nuk do të arrijmë 5%-shin. Kuptohet që ka rrisht. Ato janë që në të ardhmen të kalohet në relaksim fiskal. Pra, edhe të mos realizohen të ardhurat, sepse përjashtoi këtu, përjashtoi aty, sigurisht që ka një gjë që nuk ndodh me ne, sepse jemi të gjithë të vetëdijshëm që në anën tjetër të bilancit qëndron rrisht i borxhit publik.

Sa u përket detyrimeve të prapambetura, ju iu referuat detyrimeve të rimbursimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë do të thotë “stokut të TVSH-së”?

Nuk ka stok të rimbursimit. Ai nuk ekziston, është vlerë dinamike, e cila vjen gjithmonë duke u ulur. Për shkak të trashëgimisë kemi pasur nga tre projekte të mëdha. Pra, në 5 vjet investime, 4 vjet TAP, apo Banker's kanë akumuluar TVSH, e cila është skeduar në marrëveshje me aktorët ekonomikë dhe presupozohet që në shtator, maksimumi deri në dhjetor të 2019-ës të gjitha detyrimet e bashkëkontraktuara që janë në një skedul të ri zerohen, ndërsa pjesa tjetër është në normalitetin e vet.

Dje unë mora një shifër të rimbursimit të TVSH-së së eksportuesve, sidomos të grumbulluesve, të cilën do ta dorëzoj në komision zyrtarisht, dhe në referencë zyrtare dhe me përgjegjësi vitin e kaluar rimbursimi ka shkuar në nivele, jua kam sjellë të tre vitet, gati 2 miliardë. Për vitin 2017 ishte diku te 1,7 miliard, por gjithsesi ato janë të kontabilizuara zyrtarisht me të gjitha detajet zyrtare të llogarive të tatimeve dhe shtetit.

Pyetja tjetër ishte: sa janë detyrimet sot? Ne kemi një politikë intensive monitoruese sa u takon detyrimeve të prapambetura. Stoku i detyrimeve të prapambetura, i cili shlyhet çdo vit, brenda vitit buxhetor, për këtë vit i riu është rreth 2,4 miliardë gjë që do të shlyhet brenda vitit ose siç është bërë traditë, le të themi për shkak të natyrës fizike të punëve, sidomos në infrastrukturë, një vit buxhetor bëhet puna prodhuese dhe faturimi është midis fundit të vitit ekzistues dhe fillimit të vitit tjetër. Pra, gjëja e parë që do të bëjë ministria përgjegjëse për infrastrukturën është që menjëherë të shlyejë faturat që ka marrë në lidhje me punët e bëra në konceptin FIFO, *first in, first out*, ato që kanë ardhur të parat paguhen të parat.

Unë besoj se e njëjta gjë po ndodh edhe pushtetin vendor, i cili ka akumuluar afërsisht rreth 12 miliardë lekë, të cilat janë në reduktim e sipër. Ne kemi një skedul jashtëzakonisht shumë taksativ me pushtetin vendor në shlyerjen e detyrimeve. Tirana ka pasur momentin ku në 2015-ën u bë ndryshimi si rezultat i zgjedhjes së kryetarit të ri të bashkisë dhe si rezultat ka pasur një detyrim të prapambetur rreth 6,5 miliardë lekë të lëna në tryezë, të cilët në kohën që jemi duke folur janë përgjysmuar. Pra, përveçse është investuar është ulur edhe stoku i borxhit.

Borxhi këtë vit do të jetë 66,9% neto dhe vitin tjetër 64,9%. Pra, praktikisht nuk kemi devijuar nga strategjia, por kemi axhustuar strategjinë. Strategjia është orientuese dhe praktikisht jemi në një trajektore intensive të uljes së borxhit publik, ndërkohë që nuk heqim dorë nga dy elemente.

Së pari, nga paketa jonë sociale.

Së dyti, nga ulja e barrës fiskale dhe mbajtja e investimeve publike në 5%.

Faleminderit!

Erion Braçe – Urdhëroni, zonja Kushi!

Evis Kushi – Më falni, zoti Ministër, por nuk më thatë përgjigje për pyetjen e fundit, për shoqëritë e ujësjellësve dhe të sektorit energjetik. A janë marrë masa që ata të shlyejnë detyrimet e huas për të mos i rënë në barrë buxhetit të shtetit, sepse buxheti i shtetit është garantuesi i huas së tyre? A janë marrë masa që këto shoqëri ta përmirësojnë performancën e tyre?

Arben Ahmetaj – Më falni, nëse mund të më sqaroni, për çfarë huash e keni fjalën?

(Diskutime pa mikrofon)

Për ujësjellësit?

(Diskutime pa mikrofon)

Sektori energjetik praktikisht ka një përmirësim të dukshëm në raport me 2013-2014. Janë reduktuar humbjet teknike dhe joteknike në 26%, është përmirësuar raporti i mbledhje së të ardhurave, pra i faturimit dhe sigurisht që i gjithë sektori nga një gjenerator problemesh është kthyer në një gjenerator të zhvillimit ekonomik.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zonja Gjylameti, urdhëroni!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti Ministër!

Unë kam një pyetje sa i përket parashikimeve në sektorin energjetik. Duke qenë se gjatë vitit 2018 situata klimaterike nuk ishte në favor dhe për këtë arsye u desh që të kishte një mbështetje buxhetore më të madhe se ajo që ishte planifikuar, do të doja të dija për vitin 2019-ën si është pjesa e parashikimeve, sepse pavarësisht faktit që sektori ka një performancë shumë më të mirë, si dhe mënyrës suaj të monitorimit dhe nxitjes për ta rritur performancën e tyre, pra, doja të dija se si janë parashikimet duke parë që viti 2018-të po mbyllet dhe kushtet klimaterike janë të njëjta me vitin që shkoi dhe se si kjo mund të ndikojë kjo më pas te borxhi publik?

Arben Ahmetaj – Në parim, çdo element që zgjeron shpenzimet apo që bën përjashtime fiskale automatikisht e rrezikon borxhin publik dhe kjo është aritmetike. Pra, çdo relaksim sipër, përjashtim, zerim apo zgjerim në shpenzime patjetër që riskon shtyllën kurrizore të financave publike, borxhin publik dhe kjo nuk diskutohet. Në rastin konkret sektori është shumë koshient për risqet që ka dhe së bashku me Bankën Botërore ne jemi duke riparë gjithë programin e përmirësimit të sektorit të energjisë, duke bërë edhe një balancim shumë të mirë

midis rezervës për thatësirën dhe investimeve. Unë mendoj që risku i thatësirës është patjetër atje, pozicionet neto që ne kemi parashikuar në buxhet janë 3 miliardë dhe kjo do të thotë që buxheti i kalon një përgjegjësi më të madhe sektorit për t'i paraprirë riskut të thatësirës. Ne prandaj themi që në kohë të mirë duhet të mendojmë për kohën e keqe. Gjatë periudhës së shirave dhe të mbushjes së rezervuareve jam i bindur që është menduar për kohën e keqe.

Blerina Gjylameti – Po vazhdoj me pyetjen e dytë, e cila lidhet me kontratat koncesionare. Meqenëse sipas shifrave që na keni sjellë pagesat vjetore nuk e kalojnë 3%-in e prodhimit të brendshëm bruto, pyetja ime lidhet me parashikimet që ju keni bërë në lidhje me kontratat e reja koncesionare, meqenëse këtu kemi edhe buxhetin afatmesëm? Dua të di se cilat janë ato? Në bazë të parashikimeve, a mund të arrijmë më shumë se 5%, apo jo?

Kisha edhe diçka për të cilën do të doja të kisha më shumë sqarime. Shikoj që fondet buxhetore, të cilat ishin planifikuar për 2018-ën për kontratat koncesionare, në total janë 7 miliardë e 37 lekë, ndërkohë ka një lloj shifre për të cilën do të doja të ma sqaronit pak më shumë që lidhet me pjesën që paguhet investimi, e cila është afërsisht 3 miliardë dhe pjesa që paguhet shpenzimet korrente. Si qëndron kjo? A ka mundësi të na e sqaroni pak më shumë?

Një pjesë prej 2,85 miliardë janë investime pra pagesat nga fondet buxhetore dhe pjesa tjetër 4,5 miliardë është për shpenzimet korrente. Do të doja të na e sqaronit pak më shumë këtë lloj proporcioni.

Faleminderit!

Erion Braçe – Më falni!

Para se ministri t'u përgjigjet pyetjeve, zonja Gjylameti, do të doja t'ju bëja me dija se ditën e martë kemi një seancë të posaçme vetëm për koncesionet. Unë mendoj se do të ishte e tepërt të hynim në detaje për sa kohë që kemi një seancë të posaçme, ku do t'i shqyrtojmë me hollësi të gjitha këto problematika që lidhen me kontratat koncesionare, për të thënë edhe disa të vërteta me thënë të drejtën, pasi është abuzuar aq shumë sa nuk ka ku të shkojë më. E mira është që ditën e martë t'i marrim një për një të gjitha kontratat që paguhet nga buxheti i shtetit me qëllim që edhe opinionin publik ta ketë të qartë përtej atyre shifrave që jepen shpeshherë nëpër tabela se cili ishte qëllimi? Çfarë produkti kemi? Cili është efekti, dhe pa asnjë lloj diskutimi, cilat janë kostot e kësaj historie?

Blerina Gjylameti – Jam dakord me ju, zoti kryetar! Megjithatë pyetja që unë bëra ngelet në fuqi, sepse ajo ishte në parim për të kuptuar risqet që kanë kontratat koncesionare në buxhetin e shtetit dhe në borxhin publik.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Siç jua sqarova, mënyra e kontabilizimit, po i lidh gjërat nëse më lejoni, është në referencë të standardeve ndërkombëtare. 90% e vendeve të Bashkimit Europian kontabilizojnë si ne, pra OESA 95, OESA 2010, të cilat i referohen në finale dhe ajo që qëndron përtej kësaj logjike është ndarja e riskut midis qeverisë dhe partnerit publik-privat. Në këndvështrim tim ne jemi planifikuar shëndetshëm përtej uljes së kufirit 5%. E theksoj, risku, pasi ka disa risqe, është në të ardhmen jo me këtë maxhorancë, sepse kjo maxhorancë nuk e ka stil, por një maxhorancë pas 15 vjetësh që do të bëjë relaksime fiskale dhe përjashtime populiste ajo e riskon në themel patjetër.

Me maxhorancën aktuale, e cila është mjaft e përgjegjshme, nuk shoh asnjë lloj risku sa i takon qoftë shpenzimeve, qoftë të ardhurave. Ajo që dua t'ju them është se planifikimi shkon në ekstremin e vet të rreth 4,2% për të marrë parasysh edhe ndonjë risk makro-ekonomik. Kjo do të thotë se rritja ekonomike nuk është ajo që ne parashikojmë, ose partnerët tanë, siç po ndodh me Italinë, kanë goditje dhe nuk rriten me 2 apo me 3% sa ç'e kanë parashikuar, por rritja po shkon 1% dhe kjo influencon te ne. Ne mendojmë për vendin tonë dhe kjo as që nuk diskutohet, por, gjithashtu, shohim nga të gjitha anët edhe risqet që janë eksternale, që mund ta godasin ekonominë, por besoj se ne jemi në një trajektore shumë të sigurt të nivelit nën 5%.

Në qoftë se doni informacion për investimet dhe pse të shpenzimet, do t'ju thosha se një pjesë e tyre janë shërbime, një pjesë janë investime, një pjesë është konceptuar me *entity payments*, një pjesë është konceptuar të mirëmbajtja dhe shërbim e sipër.

Faleminderit!

Erion Braçe – Urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër, për prenzatimin që na bëtë për borxhin publik dhe deficitin buxhetor!

Duke iu referuar parashikimeve të rritjes ekonomike, si dhe deficitit buxhetor të planifikuar, nivelit të borxhit publik për vitin 2019, do të doja të dija se cilat janë disa nga risqet, të cilat sipas mendimit tuaj do të ndikojnë në borxhin publik për vitin 2019?

Arben Ahmetaj - Siç jua theksova edhe në prezantimin tim ka risqe të brendshme, por ka edhe risqe të jashtme dhe më pas ne praktikisht u referohemi si risqe me probabilitet të ulët, me probabilitet të mesëm dhe probabilitet të lartë për të ndodhur. Një nga risqet kryesore janë normat e interesit në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Jam i bindur se ju tashmë jeni të mirinformuar për planin e rritjes së interesave nga *Federal Reserve*, Banka Qendrore e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e planifikuar me 0,25% për një periudhë gati 3-vjeçare. E njëjta gjë mund të ndodhë edhe në Europë dhe në Bashkimin European, pasi tendencat janë, aq më tepër që së fundmi ka një tërheqje të bankës Qendrore Europiane nga *Quarto Division*, të deklaruar zyrtarisht.

E treta, sigurisht që çdo shok makro-ekonomik që mund t'i ndodhë vendit automatikisht transferohet në një borxh më të lartë. Çdo rritje më e ulët e PBB apo relaksim fiskal që mund të bëjmë ne që janë risqe të mundshme, do të thotë se ato prekin menjëherë nivelin e borxhit dhe pastaj automatikisht materializohen një sërë elementesh negative mbrapa, si: nevoja për financim, provokimi i financimit në tregut të brendshëm më i madh se ai që kemi planifikuar, rritja e interesave në tregun e jashtëm dhe të gjitha këto përkthehen në shërbim më të lartë, por jo sa është sot 2.41%, sepse prodhimi i brendshëm ka qenë 3.2-3.3%, nëse e mbani mend tmerrin që kemi hequr në vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015. Pra, risqet janë makroekonomike të brendshme, por janë edhe risqet e jashtme që unë iu referova.

Erion Braçe – Fjalën e ka zoti Bushaj.

Xhavit Bushaj – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër, për të gjithë ekspozenë që i bëtë buxhetit në përgjithësi, por në veçanti deficitit buxhetor dhe borxhit publik, për të cilët po diskutojmë sot. Unë kisha një pyetje konkrete, e di që të gjitha gjërat konvergojnë te këta dy tregues cilësorë për ecurinë e ekonomisë dhe tendenca jonë është që të ulim vazhdimisht borxhin publik. Një nga faktorët që shkon për uljen e borxhit publik janë të ardhurat nga privatizimet. A është planifikuar për vitin 2019 një gjë e tillë që të ardhurat nga privatizimet të shkojnë për uljen e borxhit publik? Nëse jo, përse? A kemi sektorë të veçantë drejt privatizimit që pjesa e të ardhurave të kalojë për uljen e borxhit publik dhe për investimet?

Arben Ahmetaj – I ka mbaruar Saliu të gjitha ato që ishin për t'u privatizuar, nuk ka më.

Xhavit Bushaj – Pra, nuk janë planifikuar.

Arben Ahmetaj – Praktikisht edhe ato që ishin i shiti Saliu përpara se të ikte. Ditën e fundit ministri i Ekonomisë së asaj kohe, në një ditë të shtunë, ka firmosur 23 koncesione, përpara se të linte zyrën.

Planifikimi i të ardhurave nga privatizimi është modest, sepse bëhet fjalë për asete periferike që janë të pazhvilluara ose të braktisura për shkak të interesit të ulët ose vlerës jo të madhe, por kryesisht kanë interes të ulët për zhvillimin e tyre. Në afatmesëm, sigurisht në horizontin e qeverisë, për të planifikuar privatizim do të ishte distribucioni i energjisë elektrike, por nuk është planifikuar për vitin 2019, sepse ka kohë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Fjalën e ka zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit, kryetar!

Borxhi publik është nën kontroll dhe ky është një lajm i mirë, për të cilin ia vlen të thuhet dy fjalë përgjegjëse për qeverinë dhe ministrinë. Pra, nuk përbën më kërcënim. Është pozitive që dalja në tregje sot është shumë më e ulët dhe rakordimi me FMN-në për të ulur borxhin nëpërmjet rritjes ekonomike është bërë. Kjo është diferenca që ne shpeshherë nuk e kuptojmë tamam, sepse nëpërmjet rritjes ekonomike dhe deficitit buxhetor është mënyra më e mirë për të ulur borxhin dhe jo thjesht duke paguar para. Pra, rritja ekonomike duhet ta tejkalojë borxhin dhe ky është varianti më i mirë që të mos përdoret parashuta, siç u përdor në disa raste gjatë krizës.

Kam një pyetje më shumë për publikun: sa është kursimi nga ky operacion financiar, pra në vit sa euro u fituan me uljen e interesit me daljen me eurobond?

E dyta, deri në sa vite mendohet që duhet shkojë në nivelin afatmesëm? Pavarësisht shumë teorive që të presim të shkojë deri në 45%, gjë për të cilën nuk mendoj që Shqipëria nuk është në atë emergjencë dhe nuk e ka atë luks, në vitet që do të vijnë do të duhet që të rriten më shumë investimet, pra deri sa mendohet se do të mbahet kjo?

Pyetja e tretë, të gjitha këto kanë çuar në një relaksim të normave të interesit, pra kjo ka qenë idea që të ulen normat e interesit për të rritur financimet në tregje, pra të rritet kreditimi. Dua të di se si po shkon ky proces. Ne kemi edhe investimet, që janë një vlerë e shtuar, përmes PPP-ve si aksion financiar, a parashikohet të rritet kreditimi apo ku po gjenden fondet? Kjo është pyetja e tretë. Pra këto investime të mëdha që po nisin po adresohen brenda sistemit tonë bankar

apo po merren nga jashtë dhe si parashikohet të shkohet në të ardhmen, sepse neve na intereson që të rritet kreditimi sa më shumë dhe të krijohet efekti distributiv që të rishpërndahet mirëqenia.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Vetëm nga kombinimi mes *bay back*-ut që bëmë në eurobond (pra blerjes mbrapsht) dhe daljes me afatgjatë 7-vjeçar me çmim kuponi 3.5% shkojnë rreth 37 milionë euro në total. Por, 10 miliardë lekë në vit është presimi i interesave poshtë për shkak të transaksionit. Pra jemi duke folur për një transaksion shumë fitimprurës për Republikën e Shqipërisë, ku kursimi nga interesat e ulura shkon në 10 miliardë lekë. Por nuk duhet të harrojmë kur mendojmë për të ardhurat dhe shpenzimet, sepse gërryhet kollaj nëse kalohet në relaksim, si benefit për buxhetin dhe për vendin. Kjo ishte e para.

Unë mendoj që kemi arritur një rezultat shumë të mirë nëpërmjet eurobondit në reflektim të të gjitha reformave, sepse janë kursime reale të prekshme, pavarësisht se çfarë krenarie mund të ketë mazhoranca apo secili nga ne për sa i përket transaksionit.

Pyetja e dytë ishte në referencë të sistemit bankar?

Ervin Bushati - Pyetja ishte për nivelin e borxhit. Sa mendoni që duhet të jetë optimal dhe deri në sa vite duhet të vazhdojmë? Ne jemi shumë mirë, sepse kemi dëgjuar FMN-në dhe kemi hyrë në këtë trajektore, pra kur mendoni, pak a shumë, në cilin vit mund të dalim nga kjo lloj ortodoksie në investime apo në sjellje me FMN-në?

Arben Ahmetaj – Unë besoj se është shpejt për të menduar për ndalesën, sepse jemi në emergjencë ulje. Pra, është shumë shpejt për të thënë që erdhi dita për të ndaluar uljen e borxhit, sepse jemi shumë larg asaj periudhe. Këtë vit borxhi publik mbyllet me 67% dhe përsëri është shumë i lartë. Unë mendoj që kjo maxhorancë duhet ta ulë sa më shpejt që të jetë e mundur borxhin dhe mes 45 e 50% është optimale, secili ka mendimin e vet profesional, por mendimi zyrtar është ky që unë i referohem. Besoj se nuk duhet të ndalojmë asnjëherë në uljen e borxhit publik. Unë besoj që transaksioni dhe ulja e borxhit, sidomos *bay back*-un që po përgatisim nëpërmjet emetimit të ankandëve në dhjetor së bashku me *bay back* – un që bëmë në tetor, përdorimi i atij likuiditeti për menaxhim të detyrimeve për vitin tjetër dhe ulja e financimit në tregun e brendshëm, siç iu referova nën 20 miliardë, do t'i vërë nën presion bankat e nivelit të dytë për të përdorur likuiditetet e tyre, sepse praktikisht po reduktojnë ekspozimin ndaj letrave të qeverisë. Kjo do të thotë që do të krijohen më shumë likuiditete në bilancet e tyre...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në dhjetor. Ne kemi riparë të gjithë skedulin e ankandeve për të tërhequr financim nga tregu, për shkak se po reduktojmë pozicionet e brendshme. Kemi likuiditete të mjaftueshme të përfituar nga eurobondi. Një nga qëllimet kryesore të eurobondit ishte menaxhimi i detyrimeve, pra nëse e mbani mend është shpejtësia e daljes në treg, atë që unë e quajta emergjencë e daljes në treg, dhe ja ku jemi sot jo më larg se 1 muaj e gjysmë ku kushtet e tregut janë krejt të ndryshme në shumë dimensionë. Kjo na dha mundësinë që të bëjmë një transaksion që i vlen tregut të brendshëm për vitet 2019 dhe 2020, interesave dhe kursimit që iu referova me 37 miliardë dhe 10 miliardë për vit, për shkak të presimit të interesave në tregun e brendshëm. Kjo do t'i japë mundësi që të lërë më shumë hapësirë për kredi në ekonomi me interesa më të ulëta dhe me shifra më të larta. Po e shpjegoj me fjalë më të thjeshta për qytetarët, tërheqja e qeverisë nga tregu i brendshëm, së pari lë hapësirë më shumë për bankat që të japin kredi për ekonominë, pra për privatët dhe ky është qëllimi dhe e dyta ul interesin. Pra, ka edhe shumë konsekuenca të tjera pozitive, por dy janë në ankora.

Faleminderit!

Ervin Bushati – Pyetja e tretë ishte kur do të fillojë të ndihet kjo te kreditimi, sepse thamë që do të fillojnë shumë punime publike që janë ekstra buxhetore dhe a kemi ndonjë vlerë se sa shtohet ekonomia në vit nga këto investime?

Arben Ahmetaj – Shenjat janë dhënë kryesisht në kredinë për konsumatorët dhe për banesa të rritura në 5-6% të dyja, pra me ritme shumë të kënaqshme. Korporatat akoma kanë një nivel rritje të papërfillshme, pra biznesi i madh. Megjithatë mund t'ju jap një shembull, një nga projektet me partneritet publik privat ka përmbyllur një transaksion kredie të madhe me një bankë vendase. Pra, menjëherë u materializua nevoja dhe furnizimi i nevojës me likuiditet, në rastin e një partneritetit publik privat. Një partneritet publik privat në infrastrukturë është shumë i rëndësishëm me një shifër të konsiderueshme. Në varësi të hyrjes në ekonomi të bërjes së këtyre investimeve në pjesën fizike, kuptohet edhe me transaksionet, besoj që ndër vite ritmi i rritjes do të jetë të paktën 1% plus, përveç faktorëve të tjerë konsektivë që do t'i numërojmë në muajt në vazhdim.

Faleminderit!

Erion Braçe – A ka pyetje apo diskutime të tjera? Nuk ka. Mbyllim këtu shqyrtimin e deficitit buxhetor dhe borxhit publik parashikuar për vitin 2019.

Përpara se të mbyllim mbledhjen, ditën e hënë kemi një seancë me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë për marrjen e opinionit të Bankës së Shqipërisë, ashtu siç e kërkon ligji “Për projektbuxhetin e viti 2019” dhe ditën e martë do të fillojmë me seancën për koncesionet dhe partneritetin publik privat të parashikuar në projektbuxhetin e vitit 2019, më pas kemi votimin në parim të projektligjit për buxhetin e shtetit dhe të gjitha ligjeve të paketës fiskale.

Do t’u lutesha të gjithë kryetarëve të komisioneve që brenda ditës së nesërme të dorëzojnë raportet e komisioneve respektive të Kuvendit, lidhur me këto dy akte që do të shqyrtojmë ditën e martë. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve është detyrim, prandaj duhet t’i njoftojmë me qëllim që deri nesër çdo komision të dorëzojë raportet, përndryshe, siç u është bërë e qartë, nuk kemi se çfarë të marrim parasysh përtej këtij afati.

Mbledhja mbyllet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA